



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstrakti i Procesverbalit dhe Transkripti i mbledhje së 25-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: 26, 27, 28 dhe 29 elektronike \korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Zhvillimin e Procedurave të Rekrutimit për Zjarrfikës.
2. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Lu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/30
Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, si dhe neneve 9 dhe 13 të Rregullores Nr. 03/2025 për Kushtet e Bartjes së Pronësisë së Pronës Publike dhe Dhënia me Qira e Sendeve në Pronësi Publike, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet qiradhënia për sipërfaqen prej 61402.9 m², e cilat gjendet në pjesë të parcelës P-72809071-00070-0 dhe P-72809071-00075-0, zona kadastrale Raçak, Komuna Shtime, sipas Kërkesës nga Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kohëzgjatje prej 15 vjetësh për nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror.
2. Obligohet Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe operatori ekonomik, që brenda 30 ditëve ta nënshkruajnë kontratën për dhënien me qira, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe të gjitha institucionet kompetente, sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Zyra për Administrimin e Pronës Publike, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me datë 06.07.2026, në mënyrë zyrtare, përmes Shkresës Protokoll Nr. 173/153 "Akti përcjellës i draft-kontratës për OE "Tony Company"", ka pranuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës/Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Kërkesën për marrjen e vendimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-125 për Pronën Publike, për lëshim me qira të sipërfaqen prej 61402.9 m², e cilat gjenden në pjesë të parcelës P-72809071-00070-0 dhe P-72809071-00075-0, zona kadastrale Raçak, Komuna Shtime.

- Për lëshimin me qira të kësaj hapësire, Agjencia Pyjore e Kosovës ka përgatitur dosjen sipas legjislacionit në fuqi, e cila përmban të dhënat e autoritetit kontraktues, të dhënat bazë për pronën ku përfshihet lokacioni, sipërfaqen e propozuar për qira, destinimin aktual dhe atë të propozuar për qira, numrin e parcelës, dokumentet e pronësisë, kohëzgjatjen e qirasë për 15 vjet, si dhe vlerën e qirasë vjetore për këtë kategori.

Me datë 03.03.2026, Zyra për Administrimin e Pronës Publike ka pranuar Shkresën me nr. prot. 173 dhe e ka plotësuar me dosjen nr. prot. 717, datë 19.06.2026, në ZKM, me subjekt kërkesë "Kërkesë për marrje të pëlqimeve paraprake", pjesës së parcelës nr. P-72809071-00070-0 dhe P-72809071-00075-0, zona kadastrale Raçak, Komuna Shtime, me sipërfaqe prej 61402.9 m², me qëllim: Nxjerrjen dhe shfrytëzimin e gurit gëlqeror. Tutje, për shqyrtimin e Kërkesës është zbatuar neni 10, paragrafi 2, i Rregullores Nr. 02/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e ZAPP-së në Zyrën e Kryeministrit, mirëpo u vërtetua se asnjë institucion tjetër nuk ka interes publik për atë pronë.

Pas inspektimit në terren nga zyrtarët e ZAPP-së dhe konstatimit se kjo sipërfaqe shfrytëzohet për të njëjtin qëllim siç edhe është propozuar të jepet me qira, me datë 22.06.2026, prot. 173/150, ZAPP-i lëshon Pëlqimin Parimor në pajtim me Vendimin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me nr. 3338, datë 02.06.2026.

Tutje, janë zhvilluar procedurat sipas legjislacionit në fuqi nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe, në qershor 2026, ka përpiluar draft-kontratën me titull "Kontratë për qiranë e tokës pyjore", për sipërfaqen 61402.9 m², në kohëzgjatje 15 vjet, mbështetur në nenin 6, pika 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2025, që për secilën m² të sipërfaqes së marrë me qira, t'i paguajë Agjencisë Pyjore të Kosovës 0.10 euro/m²/vit dhe obligimi për pyllëzimin e sipërfaqes së njëjtë të marrë me qira dhe mirëmbajtje për trevjetorin e parë të mbjelljes së fidanëve. Kushtet, mënyra e pyllëzimit dhe lokacioni përcaktohet nga Agjencia.


Për sipërfaqen prej 61402.9 m²*0.10 cent/vit*15vite=92,104.35€.

Duke marrë parasysh arsyetimin, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesë administrative. Palët e pakënaqura mund të paraqesin padi për inicimin e konfliktit administrativ pranë Gjykatës Administrative të Republikës së Kosovës, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, pas publikimit të Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafi 3, të Ligjit 08/L-137 për Pyjet, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet dhënia në shfrytëzim e një hapësire prej rreth 30 ari nga parcela kadastrale P-71813068-09013-16, e cila është në pronësi të Agjencisë Pyjore të Kosovës - Ndërmarrja e Pyjeve në Prizren, për Ministrinë e Drejtësisë.
2. Dhënia në shfrytëzim e kësaj prone Ministrisë së Drejtësisë do të kontribuojë në krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore për realizimin e nevojave institucionale të kësaj Ministrie, në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në racionalizimin e kostove operative.
3. Parcela e identifikuar është verifikuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës dhe është konstatuar se është e përshtatshme për t'ia dhënë në shfrytëzim Ministrisë së Drejtësisë.
4. Obligohen Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Pyjore Kosovës për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2026 për Shkollimin Specialistik, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/16, të datës 30 prill 2026

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/16, të datës 30 prill 2026, si në vijim:
 - Ministria e Shëndetësisë do të mbështesë financiarisht vetëm specialistet lehona, të cilat janë kthyer nga pushimi i lehonisë dhe, si pasojë e ndërprerjes së vijimit të programit specialistik gjatë kësaj periudhe, nuk i kanë përfunduar modulet/ciklet e trajnimit specialistik të parapara sipas programit të specializimit. Mbështetja financiare realizohet nga kategoria ekonomike "Subvencione dhe transfere", nënprogrami "Aftësimi Specialistik", kodi EVM 90300, për periudhën nga 1 nëntor 2025 deri më 31 dhjetor 2026.
2. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/16, të datës 30 prill 2026.
3. Obligohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe institucionet e tjera relevante, t'i kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Korniza për Ndërtimin e Kapaciteteve Digjitale për Qeverinë e Kosovës, që do të shërbejë si një model që siguron një qasje të unifikuar për zhvillimin e aftësive digjitale thelbësore për qeverisje efektive, ofrimin e shërbimeve dhe inovacionin në një mjedis digjital.
2. Obligohet Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike për ndërmarrjen e hapave në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/-L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për aderimin në zonën "EU Roam Like at Home", e cila do të jetë parakusht për implementimin e plotë të "EU Roaming Acquis".
2. Obligohet Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike për ndërmarrjen e hapave në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/-L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, "Termokosit" dhe Bankës Evropiane për Investime, për Projektin e Zgjerimit të Sistemit të Ngrohjes Qendrore në Prishtinë.
2. Obligohet Ministria e Financave për ndërmarrjen e hapave në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/30
Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 13, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumën prej: 2,000,000.00€ (dy milionë eurosh), në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me kod 212, nënprogrami "Administrata qendrore", me kod 11312, nga kategoria e shpenzimeve kapitale, konkretisht nga projekti kapital "Programi për Grantin e Performancës Komunale", me kod 20659, në 15 (pesëmbëdhjetë) projekte kapitale, në përputhje me 15 (pesëmbëdhjetë) marrëveshjet për mbështetje financiare, për projektet kapitale të nënshkruara nga Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetarët e komunave përkatëse.
2. Mjete nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga projekti kapital "Programi për Grantin e Performancës Komunale", me kod 20659, për 15 (pesëmbëdhjetë) projekte të reja:
 - 2.1. Projekti "Zgjerimi i rrugës Rrenc deri te Lapidari", Komuna e Dragashit, në vlerë prej 200,000.00€;
 - 2.2. Projekti "Rehabilitimi dhe Zgjerimi i rrugës TAKE OFF në fshatin Brezne", Komuna e Dragashit, në vlerë prej 90,000.00€;
 - 2.3. Projekti "Ndërtimi i stadiumeve dhe infrastrukturës përcjellëse në fshatrat Kosave, Bellobrad, Shajne", Komuna e Dragashit, në vlerë prej 50,884.28€;
 - 2.4. Projekti "Rregullimi dhe Asfaltimi i rrugës Stratorja - Brod", Komuna e Dragashit, në vlerë prej 62,000.00€;
 - 2.5. Projekti "Ndërtimi i Infrastrukturës në fshatin Mlikë", Komuna e Dragashit, në vlerë prej 70,000.00€
 - 2.6. Projekti "Ndërtimi i ndriçimit publik në Dragash, Buqe, Zym, Zgatar, Pllanik, Qollopek, Buzez, Brezne, Xërxë dhe Zaplluxhe", Komuna e Dragashit, në vlerë prej 95,500.00€
 - 2.7. Projekti "Ndërtimi i Sheshit Qendror të Qytetit - ritenderim (Ndërtimi dhe rregullimi estetik - faza përfundimtare)", Komuna e Rahovecit, në vlerë prej 192,620.39€;
 - 2.8. Projekti "Ndërtimi i rrugëve dhe kolektorët për ujërat e zeza", Komuna e Rahovecit, në vlerë prej 676,500.00€;
 - 2.9. Projekti "Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirës së parkimit në fshatin Pasjan", Komuna e Parteshit, në vlerë prej 16,245.66€;
 - 2.10. Projekti "Kubëzimi i rrugëve lokale në territorin e Mamushës", Komuna e Mamushës, në vlerë prej 62,132.04€;
 - 2.11. Projekti "Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel - Kernicë - Klinë, Dresnik, Dollc dhe Jashanicë", Komuna e Klinës, në vlerë prej 40,000.00€;

- 2.12. Projekti "Rindërtimi i sheshit të qytetit të Klinës dhe rrugës Azem Desku dhe Skender Rexhepi" Komuna e Klinës, në vlerë prej 281,314.71€;
 - 2.13. Projekti "Ndërtimi i segmenteve të rrugëve me infrastrukturë nëntokësore në rrugët Qyteti Antik, Dardania, Malë Bashota, dhe Martirët e Dollcit në Dresnik, Dollc", Komuna e Klinës, në vlerë prej 90,000.00€;
 - 2.14. Projekti "Ndërtimi i ujësjellësit për fshatrat Pataqan - Leskoc - Ranoc - Zllakuqan", Komuna e Klinës, në vlerë prej 50,000.00€;
 - 2.15. Projekti "Ndërtimi i rrugëve në Jashanicë - Jelloc - Resnik", Komuna e Klinës, në vlerë prej 22,802.92€.
3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij Vendimi.
 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/30
Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 19 të Ligji Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Kombëtar i Arteve, në këtë përbërje:

- 1.1. Yll Rugova, përfaqësues nga fusha e arteve pamore;
- 1.2. Baki Jashari, përfaqësues nga fusha e muzikës klasike dhe operës;
- 1.3. Visare Aliu, përfaqësues nga fusha e teatrit;
- 1.4. Afrim Spahiu, përfaqësues nga fusha e filmit dhe fusha audiovizuale;
- 1.5. Ardianë Pajaziti, përfaqësues nga fusha e letërsisë dhe librit;
- 1.6. Visar Munishi, përfaqësues nga fusha e këngëve dhe valleve folklorike;
- 1.7. Aulona Nuhii, përfaqësues nga fusha e baletit dhe vallëzimit modern;
- 1.8. Alberta Troni, përfaqësues nga institucionet akademike dhe kërkimore në fushën e artit dhe kulturës;
- 1.9. Arif Muharremi, përfaqësues nga sektori i pavarur kulturor që përfshin organizatat, institutet dhe shoqatat e fushës së artit dhe kulturës dhe fushat e ndërlidhura me kulturën;
- 1.10. Artnet Haskuka, përfaqësues nga fushat e ndërlidhura me kulturën, si dizajni, arkitektura apo fusha të ndërlidhura me industrinë kreative;
- 1.11. Visar Haxhibeqiri, përfaqësues i administratës nga Ministria e Kulturës.


2. Mandati i anëtarëve të Këshillit nga pika 1. e këtij Vendimi është pesë (5) vjet.

3. Te drejtat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar të Arteve janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën dhe me Rregulloren Nr. 01/2026 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar të Arteve.

4. Për anëtarët e Këshillit Kombëtar të Arteve të emëruar me këtë Vendim, kompensimi bëhet çdo dy muaj kalendarik. Kompensimi është i barasvlershëm me vlerën e koeficientit të pagës së Zyrtarit Kryesor Administrativ, të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 10/001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumë prej 9,480.00€ (nëntë mijë e katërqindetëdhjetë eurosh), për mbështetjen e realizimit të programit "OriginAL", i cili promovon Republikën e Kosovës në nivel ndërkombëtar përmes forcimit të imazhit pozitiv të Republikës së Kosovës, promovimin e potencialit të saj turistik, kulturor dhe zhvillimor, si dhe në zgjerimin e bashkëpunimit me diasporën në funksion të zhvillimit afatgjatë të vendit.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi, ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami "Programi për Promovim të Vendi" dhe barten në xhirollogarinë e organizatës respektive.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafëve 1, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e Autorizimit Ministrit të Financave, për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim, për Projektin e Lojërave Mesdhetare XXI në Kosovë.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij Vendimi, në pajtim me afatin e përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/30

Datë: 24.07.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Riaprovohet Raporti Vjetor Financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi, ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas kërkesave të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë